



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 160

Tiranë – E hënë, 14 shtator 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Punëve të Brendshme nr. 439, datë 21.8.2015	Për kryerjen e shërbimeve të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore..... 11325
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5696, datë 9.9.2015	Për delegim kompetence..... 11341
Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 71, datë 3.9.2015	Për një ndryshim në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”, të ndryshuar..... 11341
Kërkesë e ministrit të Punëve të Jashtme nr. 14759, datë 2.9.2015	Për shpronësim publik të një pjese të pasurisë së paluajtshme “Ofiçina e Automjeteve Tiranë”..... 11341
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4517, datë 2.9.2015	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Librazhd-Q. Stude (shtesat)” për: tokë arë, kultura bujqësore dhe dru frutorë..... 11342
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Panajot Miçi Kolo..... 11345
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Romeo Beluli..... 11345

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****N. 439, datë 21.8.2015****PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË
GJENDJES CIVILE NË PËRFAQËSITË
DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE**

Në zbatim të Kushtetutës, neni 102, pika 4, nenit 34, 61 dhe 71 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, nenit 11 të ligjit nr. 8372, datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore”, të ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008, “Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Sagem Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes së afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, të ndryshuar, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së punës të nëpunësve të shërbimit konsullor, si dhe ofrimin e shërbimeve për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit,

UDHËZOJMË:

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre konsullore, kryejnë funksione/shërbime të gjendjes civile, respektivisht si më poshtë:

a) Lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja, sipas modeleve të miratuara për përdorim nga autoritetet e huaja në postet konsullore:

- kodi 501, që i korrespondon Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë;

- kodi 502, që i korrespondon Konsullatës së Përgjithshme në Milano;

- kodi 503, që i korrespondon Konsullatës së Përgjithshme në Bari.

Ky shërbim do të ofrohet për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike, si dhe pasi të jenë kryer veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) për plotësimin dhe saktësimin e rubrikave “vendlindja” dhe “vendbanimi”, si përbërës të gjendjes civile.

Hapat e nevojshëm proceduralë, veprimet që do të kryhen nga nëpunësit e autorizuar të shërbimit konsullor në RKGJC ilustrohen në manualin përkatës, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, aneksi 1, “Manuali për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja në postet konsullore”.

b) Certifikimin dhe autorizimin e aplikimit dhe pajisjen me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike), në përfaqësitë diplomatike/postet konsullore ku ofrohet shërbimi i pajisjes me dokumente identiteti.

Ky shërbim do të ofrohet për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike, si dhe pasi të jenë kryer veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) për plotësimin dhe saktësimin e rubrikave të “vendlindjes” dhe “vendbanimit”.

c) Korrigjimin e rubrikës “vendlindja”, vetëm për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike dhe që paraqiten për t’u pajisur me certifikata për përdorim nga autoritetet e huaja me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike), në përfaqësitë diplomatike/postet konsullore ku ofrohet ky shërbim.

Hapat e nevojshëm proceduralë, veprimet që do të kryhen nga nëpunësit e autorizuar të shërbimit konsullor në RKGJC ilustrohen në manualin përkatës, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, aneksi 2, “Manuali për mënyrën e plotësimit të rubrikës “vendlindja” në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve shqiptarë”.

d) Plotësimin e rubrikës “vendbanimi”, sipas elementeve të adresës jashtë vendit për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike dhe që paraqiten për t’u pajisur me certifikata për përdorim nga autoritetet e huaja dhe me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike), në përfaqësitë diplomatike/postet konsullore ku ofrohet ky shërbim.

Hapat e nevojshëm proceduralë, veprimet që do të kryhen nga nëpunësit e autorizuar të shërbimit konsullor në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes



Civile ilustrohen në manualin përkatës, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, aneksi 3, “Manuali për mënyrën e plotësimit të rubrikës “vendbanimi” sipas elementeve të adresës jashtë vendit të shtetasve shqiptarë”. Rastet për të cilat lëshohen certifikatat dhe dokumentacioni përkatës, përcaktohen në pikën 5 të këtij udhëzimi.

Drejtoria e Çështjeve Konsullore do të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për çdo ndryshim apo emërim të ri të nëpunësve në shërbimin konsullor.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është përgjegjëse për trajnimin e nëpunësve konsullorë, sipas një plani të miratuar paraprakisht me Drejtorinë e Çështjeve Konsullore.

Nëpunësit konsullorë do të ofrojnë shërbime të gjendjes civile vetëm pasi të kenë kryer trajnimin e nevojshëm, si dhe:

a) me kërkesë të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile hap/mbyll llogarinë përkatëse, të drejtat e përdorimit për nëpunësit konsullorë në RKGJC;

b) për nëpunësit konsullorë bëhet njoftimi i fillimit të detyrës, të cilët depozitojnë specimenet e tyre në Drejtorinë e Çështjeve Konsullore dhe te autoritetet e vendit pritës.

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të miratuara, lëshojnë certifikata për përdorim nga autoritetet e huaja vendore, pasi të jetë verifikuar më parë se këto dokumente do të njihen dhe pranohen nga autoritetet e vendit pritës dhe:

a) pajisin me certifikata vetëm shtetasit me qëndrim në rrethin e juridiksionit të postit;

b) me kërkesë të prindërve, për shtetasit nën 16 vjeç, certifikata mund të lëshohet me foto;

c) për t’u pajisur me certifikatë për përdorim nga autoritetet e huaja vendore, shtetasi paraqitet personalisht me:

c.1 letërnjoftim elektronik/pasaportë biometrike;

c.2 dëshmi të qëndrimit të rregullt e të regjistruar në rrethin konsullor të postit, që

- mund të jetë një nga dokumentet e mëposhtme:

- certifikatë rezidence/vendbanimi, e lëshuar nga komuna ose;

- deklaratë personale për vendbanimin, e vërtetuar nga komuna ose;

- kopje kontrate banimi e vlefshme jo më pak se 12 muaj, e noterizuar ose;

- kartë identiteti, ku shënohen të dhënat për vendbanimin;

c. 3 dëshmi të kryerjes së pagesës së tarifës me bankë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile furnizon periodikisht me certifikata të papersonalizuara, Drejtorinë e Çështjeve Konsullore, me kërkesë të kësaj të fundit. Drejtoria Konsullore merr masat për shpërndarjen e dërgimin tyre në (drejtim të) posteve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Konsullore marrin masa për drejtimin metodik të aktivitetit lidhur me shërbimin e gjendjes civile në postet konsullore. Në aktivitetin e tyre postet marrin udhëzimet nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore.

Tarifa e lëshimit të certifikatës përcaktohet me aktin e përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Financave, përkatësisht me udhëzimin nr. 61/1, datë 5.1.2015, dhe 18132/1, datë 31.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDASHME
Saimir Tahiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES CIVILE
MANUAL PËRDORIMI PËR PROGRAMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË
GJENDJES CIVILE “RKGjC”

MËNYRAT E KËRKIMIT

➤ **Si mund të hyni në sistem dhe fushat e kërkimit:**

Për të hapur sistemin përdorim internet explorer, mozilla ose google chrome dhe kërkohet programi me këtë adresë IP : **95.107.164.33**. Klikojmë butonin enter dhe shfaqet pamja si më poshtë:

Plotësohet fusha 'Emri i përdoruesit' i cili është : **emër.mbiemër@moi.gov.al**

Plotësohet fusha 'Fjalëkalimi' sipas fjalëkalimit që ju është caktuar.

Pasi të klikojmë butonin 'Dërgo' do të shfaqet një tjetër tabelë që do të kërkojë ndryshimin e fjalëkalimit. Tek fusha e parë "Fjalëkalimi i vjetër" do vendosni fjalëkalimin që ju ishte caktuar, kurse tek dy fushat e tjera një fjalëkalim që ju preferoni (mundësisht me gërma të vogla dhe të mëdha, si dhe numra).



Pasi të plotësohen këto fusha, do të shfaqet kjo pamje :

Aplikacioni	Statusi	Përshkrimi
Regjistri Kombëtar i Shtetasve		
Regjistri Kombëtar i Shtetasve - Test		

Nëse klikohet tek "Regjistri Kombëtar i Shtetasve" kalohet në sistemin Production. Në këtë sistem të gjitha veprimet që kryhen, ruhen në sistemin real të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.

Nëse klikohet tek "Regjistri Kombëtar i Shtetasve-Test", kalohet në sistemin test ku mund të kryhen veprime që nuk ruhen në sistemin real të RKGjC.

Pasi klikohet tek "Regjistri Kombëtar i Shtetasve", shfaqet kjo pamje:

Këtu plotësohen të dhënat e shtetasit që kërkohet

Të dhëna personale

Emri personal: _____

Emri: _____

Mbiemri: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Shtetësia: Zgjidh...
 Sexi: ☐ Meshkull ☐ Femër

Adresa

Rrethi: Zgjidh...
 Vendi: Zgjidh...
 Rruga: _____

Numri i ndërtesës: _____
 Nr. 1: _____
 Numri i banesës, apt: _____
 Kod postar: _____

Të dhënat e dokumentit të identitetit

Numri i dokumentit: _____
 Lloji i dokumentit: Zgjidh...

Alternativat e kërkimit

☒ Historik i le mëqarshme
☐ Funsh

Alternativat për rezultatin

☐ Vetëm të dhëna aktuale
☒ Historik i shkurter

Siç shihet, fushat e kërkimit janë të shumta. Në mënyrë që të ngushtohet fusha e kërkimit dhe të dalë shtetasi i kërkuar, plotësojmë sa më shumë fusha (p.sh. emri, mbiemri dhe datëlindja ose mjafton vetëm numri personal) dhe më pas klikohet butoni 'Kërko'.

Në rastin kur emri ose mbiemri nuk është i saktë, mund të vendosen vetëm dy gërmat e para (ose më shumë) dhe pastaj të vendoset simboli *. Kjo do të thotë që sistemi gjen të gjitha emrat ose mbiemrat që fillojnë me gërmat e përcaktuara.



Procesi i regjistrimit

Kërko person | Kërkim i zgjeruar personi | Personat e gjetur | Të dhëna personale | Dokumentet identifikuese | Shtetëria | Llogaritja e informacionit | Gjatë | Vlerë | Të dhëna mbi vendikimtarin

Kërko person | U krye

Familja | Pastro | Kërko

Printo certifikatën
Printo ndryshimin e pë
Printo certifikatën hist

Arsyeja | Procesi i regjistrimit

Të dhëna personale

Nomri personal

Emri Me*

Mbiemri Sh*

Data lindja 01.06.1926

Fshati/Qyteti i lindjes

Shtetësia Zgjidh...

Seksi ☐ Mashkull ☒ Femër



Printo certifikatën personale

Informacion **Personi u gjet.**

Fshij fushat **Rruaj**

Kërko person

Krjo person

Ndrysho person

(Jo) bllokim personi

Ndrysho emrin/mbiemrin

Ndrysho venbanimin

Cregjistro vendbanimin

Kongoj venbanimin

Familja

Printo certifikatën

Printo ndryshimin e p...

Dokumentet e lëshuar

Printo certifikatën historik

Perjashtimi nga zgjedh

Raportim

Aruaro veprimin e fundit

Te dhëna personale

Numri personal **I80218024U**

Emri/mbiemri **AUREL HOXHA**

Data lindja/Vendi i lindja **18.02.1988/Suk 2,Fier**

Përzgjidhet një nga llojet e certifikatave

☐ Printimi i certifikatës familjare

☐ Printo certifikatën personale

☐ Printo certifikatën personale për përdorim nga autoritetet e huaja

☐ Printo certifikatën familjare për përdorim nga autoritetet e huaja

Përkrahje

Shkruaj numrin e certifikatës

Data për të cilën bëhet kërkitimi

Pasi selektohet lloji i certifikatës që do printohet, mbeten dy fusha për tu plotësuar : 'Përkrimi' dhe 'Shkruaj numrin e certifikatës':

- Tek "Përshkrimi" do të shkruhet arsyeja pse po lëshohet kjo certifikatë, p.sh. "Dokument";
- Tek "Shkruaj numrin e certifikatës" do plotësohet numri serial që ndodhet në formatin e certifikatës.

Pasi klikohet butoni “Ruaj” del certifikata si më poshtë :



			
		Nr. serial certifikatës	000267646
REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας		Zyra e Gjendjes Civile <u>Shalë</u> Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servizio del Registro Civile Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Αρchiαρχείο	
ÇERTIFIKATE LINDJE Birth Certificate - Certificat de Naissance - Certificado de Nacimiento - Geburtsurkunde Certificato di Nascita - Πιστοποιητικό Γέννησης			
Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Όνομα		AUREL	
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο		HOXHA	
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal number - Numero personale - Προσωπικός αριθμός		180218024U	
Emri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Όνομα Πατρός		Novrus	
Emri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Όνομα μητρός		Bukuroshe	
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γέννησης		18-02-1988	
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γέννησης		Suk 2, Fier, ALB	
Vendbanimi - Place of residence - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		Suk 2 0000 Panjohur	
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο		M	
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Familienstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση			
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe - Αγαμος/η		x	
i/e Martuar - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Εγγαμος/η		☐	
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η		☐	
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Verwitwet - Vedovo/a - Χήπος/α		☐	
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Ιθαγένεια		ALB	
Mbiemri para martese - Surname before marriage - Nom avant le mariage -			

Siç shihet në certifikatën më sipër, të gjitha të dhënat janë të përkthyer në 6 gjuhë, për autoritetet e huaja.

E njëjta procedurë ndiqet edhe për certifikatën familjare për autoritetet e huaja.



• **PRINTIMI I CERTIFIKATËS SË MARTESËS PËR AUTORITET E HUAJA.**

Klikohet tek rubrika “Akti i martesës” dhe kërkohet njëri nga bashkëshortët :

Procesi i regjistrimit

Akti i lindjes

Akti i vdekjes

Akti i martesës

Klikohet tek kjo rubrikë

Kërko akt Rezultati i kërkimit Akti i martesës Bashkëshortja Bashkëshorti Përkthyes

Informacion Aktet gjenden.

Kërko

Të dhëna personale

Numri personal

Emri Klevis

Mbiemri shehu

Data lindja

Fshati/Qyteti i lindjes

Akt

Kodi i ZGJC

Numri i aktit nga

Data e aktit nga

Procesi i regjistrimit

Akti i lindjes

Akti i vdekjes

Akti i martesës

Kërko

Krijohet shpallje

Korrigjohet shpalljen e marrë

Refuzo

Pezullo

Rivendos statusin

Krijohet martesën e shpallur

Printo

Printo certifikatë martesë

Krijohet akti i martesës

Korrigjohet aktin e martesës

Dokumentet e lëshuara

Anullimi i aktit

Pastrimi i të dhënave

Pasi del shtetasi i kërkuar, selektohet numri i aktit, si në figurë:

Procesi i regjistrimit

Akti i lindjes

Akti i vdekjes

Akti i martesës

Kërko

1 - 2 (2)

Krijohet shpallje

Korrigjohet shpalljen e marrë

Refuzo

Pezullo

Rivendos statusin

Krijohet martesën e shpallur

Printo

Printo certifikatë martesë

Krijohet akti i martesës

Korrigjohet aktin e martesës

Dokumentet e lëshuara

Anullimi i aktit

Pastrimi i të dhënave

Numri i aktit: 52/2009 Statusi: Regjistruar

Numri i aktit	Data e aktit	ZGJC
52	26.10.2009	Qendër
		Qendër

Numri personal: 160402031T

Emri/mbiemri Klevis Shehu

Data lindja/vendlindja 02.04.1986/Nivica, Tepelene

Numri personal: 1862240231

Emri/mbiemri Rukle Shehu

Data lindja/vendlindja 24.12.1988/Fier, Fier

Më pas klikohet tek rubrika “Printo” dhe selektohet një nga opsionet e printimit të certifikatës :

- Printo certifikatë martesë në gjuhë të huaj nga RKGJC;
- Printo certifikatë martesë në gjuhë të huaj nga akti i martesës.



The screenshot displays the Albanian Civil Registry System (RKGjC) interface. On the left, a sidebar lists various processes, with 'Akti i martesës' (Marriage Act) selected. Under this category, several options are listed, including 'Printo' (Print). A large arrow points to the 'Printo' option with the text 'Selektohet njëri nga opsionet e printimit' (Select one of the printing options). On the right, there are two sections: 'Statusi Shpallur' (Status Announced) and 'Statusi Regjistruar' (Status Registered). The 'Statusi Shpallur' section includes options for 'Printo shpalljen e martesës' (Print the announcement of marriage) and 'Printo lejen e martesës për përdorim nga autoritetet e huaja' (Print the marriage license for use by foreign authorities). The 'Statusi Regjistruar' section includes options for 'Printo aktin e martesës' (Print the marriage act), 'Printo certifikatë martese nga RKGjC' (Print marriage certificate from RKGjC), 'Printo certifikatë martese nga akti i martesës' (Print marriage certificate from the marriage act), 'Printo Certifikatë martese në gjuhë të huaj nga RKGjC' (Print marriage certificate in foreign language from RKGjC), and 'Printo Certifikatë martese në gjuhë të huaj nga akti i martesës' (Print marriage certificate in foreign language from the marriage act). Below these sections, there are input fields for 'Përkrimi' (Name) and 'Shkruaj numrin e certifikatës' (Write the certificate number).

- Printo certifikatë martese në gjuhë të huaj nga RKGjC, merren të dhënat nga Regjistri Kombëtar i Shtetasve.
- Printo certifikatë martese në gjuhë të huaj nga akti i martesës, merren të dhënat nga Akti i Martesës.

Pasi selektohet njëri nga opsionet, klikohet ruaj dhe del pamja e certifikatës e cila më pas printohet.



ANEKSI 2

Manuali për mënyrën e plotësimit të rubrikës “vendlindja” në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve shqiptarë

❖ Rastet e plotësimit të rubrikës “Vendlindja” për shtetasit shqiptarë që kanë lindur brenda vendit:

I. Në rastet e plotësimit me opcionin “Ndrysho person”

a. Gjetet shtetasi në RKGjC:

Procesi i regjistrimit	Kërko person	Kërko person	Kërko person	Personet e gjetur	Të dhëna personale	Dokumente identiteti	Shtetësia	Dhënim i informacionit	Daba	Nëna
Kërko person	Informacion	Personi u gjet					70100	12:22		1114
Krijo person										
Ndrysho person										
(Jo) bllokim personi	1 - 1 (1)									
Ndrysho emrin/mbiemrin										
Ndrysho vendbanimin										
Regjistro vendbanimin										
Korrigjo vendbanimin										
Familja										
Printo certifikatën										
Printo ndryshimin e pe										

Fig. Nr. 1

b. Pasi kemi përzgjedhur dhe jemi siguruar për personin e duhur, klikohet tek rubrika ndrysho person, sipas figurës Nr. 2:

1. kliko

Përzgjedhim korrigjo sipas ZGJC

Plotësohet përshkrimi

Fig. Nr. 2



1. Përzgjidhet rubrika : “Korrigjo sipas zyrës së gjendjes civile”;
2. Tek rubrika përshkrimi shkruhet: "Plotësohet vendlindja sipas Udhëzimit “Nr.7733/4 , datë 23.10.2014”;
3. Më pas plotësohen me radhë nënrubrikat përkatëse :
 - 3.1 Kur vendlindja ndodhet në ndarjen aktuale administrative :
 - Zgjidhet “Shteti i lindjes” nga lista përkatëse ;
 - Zgjidhet “Rrethi ku ka lindur” nga lista përkatëse ;
 - Zgjidhet “Fshati ose qyteti i lindjes “ nga lista përkatëse;
 - Plotësohet “Vendlindja sipas toponimit “ : fshati + rrethi/ qyteti + rrethi, sipas figurës Nr. 3.1

Krijë person

Ndrysho person

(Jo) bllokim personi
 Ndrysho emrin/mbiem
 Ndrysho venbanimin
 Cregjistro vendbanimi
 Kongjo venbanimin

Familja

Printo certifikatën
 Printo ndryshimin e pe

Dokumentet e lëshuar

Printo certifikatën hist

Përfshirimi nga zgjedh

Raportim

Anulo veprimin e fund

Pastro Ruaj

Arsyeja Korrigjo sipas ZGJC

Përshkrimi Korrigjohet vendlindja sipas Ud

Data e ndryshimit

Numri personal F90329050T

Emri Mark

Mbiemri Lala

Mbiemri para martesës

Data lindja 29.03.1959

Shteti i lindjes Shqipëri

Rrethi ku ka lindur Lezhë

Vendlindja Ungrej

Vendlindja sipas toponimit Ungrej, Lezhe

Fig. Nr.3.1

- 3.2 Kur vendlindja nuk ndodhet në ndarjen aktuale administrative :
 - Zgjidhet “Shteti i lindjes” nga lista përkatëse;
 - Klikohet opsioni i ndarjes së vjetër administrative;
 - Plotësohet “Rrethi ku ka lindur” manualisht;
 - Plotësohet “Fshati ose qyteti i lindjes “ manualisht;;
 - Plotësohet “Vendlindja sipas toponimit “ : fshati + rrethi/ qyteti + rrethi, sipas figurës Nr. 3.2

Shteti i lindjes Shqipëri

Rrethi ku ka lindur Berat

Vendlindja Q.Stalin

Vendlindja sipas toponimit Q.Stalin, Berat

Ndarje e vjetër Administrative ☒

Numri i votimit

Fig.Nr. 3.2

c. Në fund kliko “Ruaj”.

II. Në rastet e regjistrimit me opsionin krijohet person ose me akt lindje pasi ndiqet procedura e regjistrimit bëhet plotësimi i nënrubrikave të rubrikës “vendlindje” sipas pikës 3 më sipër.

KUJDES, RAST I VEÇANTË

Për rastet kur qyteti ku ka lindur është i njëjtë me rrethin ku ka lindur, psh. “Gjirokaštër, Gjirokaštër”, ose “Tiranë, Tiranë”, të ilustruar sipas figurës Nr.4:

Ndrysho emnri/mbiemri	Numri personal: I90516098J				
Ndrysho venbanimin					
Cregjistro vendbanimi	Emri/mbiemri	Datelindja/vendilindja			
Korigjo venbanimin	Mikel Lala	16.05.1060/Gjirokastr, Gjirokastr			
Familja	Lloji i vendb.	Bashkia/Komuna	Rruga	Kodi postar	Rrethi
Printo certifikaten					
Printo qelqshimin e pa					

Fig. Nr.4

Procedura që do të ndiqet për këtë rast do të jetë shkrimi VETËM njëherë i qytetit/rrethit si në figurën Nr.5:

[illegible]

Fig. Nr. 5



ANEKSI 3

Manuali për mënyrën e plotësimit të rubrikës “vendbanimi” sipas elementëve të adresës jashtë vendit të shtetasve shqiptarë

- Kërkohet shtetasi në sistem dhe më pas selektohet emrin dhe vendbanimi e më pas klikohet tek rubrika “Ndrysho Vendbanim”, si në figurë :

Procesi i regjistrimit

Kërko person Kërko person Kërko person **Personat e gjetur** Te dhëna personale Dokumente identiteti Shtetësia Bllokimi i informacionit

Kërko person Informacion Personi u gjet.

1 Krijë person

Ndrysho person

(Jo) bllokimi personi 1 - 10 (151)

Ndrysho emrin/mbiemrin

Ndrysho vendbanimin

Cregjistro vendbanimin

Korrigjo vendbanimin

2 Familja

Printo certifikatën

Printo ndryshimin e pe

3 Dokumente të lëshuar

Emri/mbiemri Datëlindja/Vendlindja

Klikojmë këtu

Lloji i vendit Bashkia/Komuna Rruga K

Klikojmë këtu

Rruga Panjohur 01

Numri personal: G00718151F

Emri/mbiemri Datëlindja/Vendlindja

- Pasi klikohet rubrika “Ndrysho Vendbanim” do të shfaqet pamja si më poshtë :

Te dhëna personale

Ndrysho emrin/mbiemrin

Ndrysho vendbanimin

Cregjistro vendbanimin

Korrigjo vendbanimin

1 Familja

Printo certifikatën

Printo ndryshimin e pe

2 Dokumente të lëshuar

Printo certifikatën hys

3 Dokumente nga ligj

Regjistro personin

Regjistro personin e fundit

Regjistro personin

Numri personal: F90104036G

Emri/mbiemri: Artan Hoxha

Datëlindja/Vendlindja: 04.01.1959/Durres,Durres

Ndryshuar ne: 25.11.2008 14:33

Funksioni i ZSC: Migration

Identifikuesi: 000074

Arsyeja: Zgjidh...

Përshkrimi: Zgjidh...

Sipas aktit të martësies

Sipas kërkesës së të interesuarit

Sipas shprehjes së institucioneve

Sipas vendimit të gjykatës

Adresa kryesore për kohë

Rrethi: Zgjidh...

Bashkia/Komuna: Zgjidh...

Vendi: Zgjidh...

Rruga:

Numri i ndërtimit:

Hyrja:

Numri i banorëve apt:

Kodi postar:

Regjistruar nga:

Regjistruar për kohë nga:

Qendrimi:

Adresa jashtë vendit:

Rrethi:

Bashkia/Komuna:

Vendi:

Shërb: Zgjidh...

Emri i familjes 1:

Emri i familjes 2:

Personi i kontaktit:

Karta postare:

Numri i telefonit:

Numri i celularit:

Numri i faksit:

Emri:

Tek arsyeja do selektohet "Sipas kërkesës së të interesuarit"

- Plotësohet rubrika 'Arsyeja', duke përzgjedhur nga menuja 'Sipas kërkesës së të interesuarit'.



- Tek rubrika 'Lloji i vendb.' përzgjedhim nga menuja 'Vendqendrim jashtë shtetit', pasi shtetasi jeton jashtë Shqipërisë, si në figurë:

[illegible]

- Tek 'Adresa kryesore/e përkohshme' plotësojmë 4 fushat 'Rruga', 'Numri i ndërtesës', 'Hyrja' dhe 'Numri i banesës, apt', si në figurë:

Të dhëna personale		Nënyshimi i fundit	
Numeri personal	F90104360	Mënyshimi më	29.11.2008 14:33
Emri i tabeles	Anxhë Hoxha	Punatësi i ZSJC	Migrohet
Datë llogaridhëse	04.01.1955-Durrës,Durrës	Organizimi	000074
Arsyja Sipas kërkesës së le interesi Parakalimi			
Llogji i vendit		Vendendëgjim jashtë shteti	
Adresa kryesore për përkatëshme Rrethi Zgjidh... Bashkia/Komuna Zgjidh... Vendi Zgjidh... Rrugë Via Lazari Numri i ndërtesës 1 Hyrja 2 Numri i banesës apt 1,2 Kodi postar Regjistruar nga Regjistruar përkatëshmi deri më Qershorësi		Adresa jashtë vendit Rrethi Bashkia/Komuna Vendi Shteti Zgjidh... Emri i banesës 1 Emri i banesës 2 Personi i kontaktit Kategoria shtetëre Numri i tatimit Numri i pajant Numri i takimit Email	

- Tek 'Adresa jashtë vendit' do plotësohen fushat 'Vendi' dhe 'Shteti', ku rubrika e shtetit është me përzgjedhje. Fusha 'Vendi' plotësohet në mënyrë manuale, ku do të vendoset çdo informacion tjetër i rëndësishëm që nuk përfshihet tek 4 fushat e 'Adresa kryesore/e përkohshme' dhe shteti, si në figurë:



Registru vendbanimin
Informacion Perso 70100 14.16 127321000000174

Plotësohen fushat dhe klikohet butoni 'Ruaj'

Te dhëna personale

Numri personal F901040360
Emri i familjes Artan Hoxha
Data lindja/vendndija 04.01.1959/Durres,Durres

Ndryshimi i fundit
I ndryshuar më 29.11.2008 14:33
Punonjësi i Zgjidh Migration
organizata 000074

Arsyeja Sipas kërkesës së të interesit
Përshkrimi

Lloji i vendit Vendeqendrim jashtë shtetit

Adresa kryesore/e përkohshme

Rrethi Zgjidh...
Bashkia/Komuna Zgjidh...
Vendi Zgjidh...
Rruga Via Lazio
Numri i ndërtesës 1
Hyra 2
Numri i banesës. apt 12
Kodi postar
Regjistruar nga
Regjistruar përkohësisht den me
Qendrimi

Adresa jashtë vendit

Rrethi
Bashkia/Komuna
Vendi Roma, Italia
Shteti Itali
Emri i firmës 1
Emri i firmës 2
Personi i kontaktit
Kutia postare
Numri i telefonit
Numri i celularit
Numri i faksit
E-mail

Plotësohet fushat: 'Vendi' dhe 'Shteti'

- Pasi plotësohen të gjitha fushat e sqaruara, klikohet butoni 'Ruaj'.

**URDHËR****Nr. 5696, datë 9.9.2015****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, piës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë deri në datën 11.9.2015, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

VENDIM**Nr. 71, datë 3.9.2015****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
AMA-S NR. 5, DATË 22.5.2013 “MBI
MIRATIMIN E PAGESAVE PËR
AUTORIZIM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa “P”, pika 16 e nenit 25 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Mediave Audiovizive

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”, të ndryshuar, fjala “Komuna” në të gjithë rastet zëvendësohet me fjalët “Njësi administrative”.

2. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala

KËRKESË**Nr. 14759, datë 2.9.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Jashtme shpall kërkesën për shpronësim publik të një pjese të pasurisë së paluajtshme “Oficina e Automjeteve Tiranë”, me përbërje si vijon:

Pasuria nr. 1/947, e ndodhur në ZK nr. 8250, vol. 25, f. 64, Tiranë, sipërfaqe totale: 761.32 m², me pronar z. Agim Islam Paja, znj. Fotika Mihal Qinami, zj. Nadire Islam Shehu, zj. Nimete Islam Deveja, z. Shpëtim Selman Qinami.

Pasuria nr. 1/160, e ndodhur në ZK nr. 8250, vol. 19, f. 73, Tiranë, sipërfaqe totale: 78.7 m², me pronar z. Agim Islam Paja, znj. Fotika Mihal Qinami, zj. Nadire Islam Shehu, zj. Nimete Islam Deveja, z. Shpëtim Selman Qinami.

Pasuria 1/944, e ndodhur në ZK. 8250, ka sipërfaqe totale 12877,61 m² dhe është regjistruar me vol. 25, f. 61. Kjo pasuri ndodhet në pronësi të pronarit z. Llaqi Lluk Çetri.

Pasuria 1/946, e ndodhur në ZK. 8250, ka sipërfaqe totale 2440.19 m² dhe është regjistruar me vol. 25, f. 63. Kjo pasuri ndodhet në pronësi të pronarit z. Llaqi Lluk Çetri.

Vlera totale e shpronësimit është e barabartë me 197,001,129.5 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e një mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë pesë) lekë.

Me anë të këtij njoftimi, në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit nr. 8651, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik”, kërkojmë të njoftojmë pronarët dhe personat e tretë të interesuar që preken nga ky shpronësim.

Ky publikim do të publikohet për një periudhë njëjavore. Brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, pronarët, apo personat e interesuar, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre pranë Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet, i ngritur pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kërkesat duhet të paraqiten të shoqëruara me dokumentet përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik”.

Fatura e shpenzimeve sipas formatit të mësipërm të dërgohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

ZËVENDËSMINISTRI
Selim Belortaja

**KËRKESË****Nr. 4517, datë 2.9.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Librazhd-Q. Stude (shtesat)” për: tokë arë, kultura bujqësore dhe dru frutorë.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listave emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit për: tokë arë, kultura bujqësore dhe dru frutorë.

Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 2 111 082 (dy milionë e njëqind e njëmbëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e dy) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT INFRASTRUKTURES
SEKTORI I SHPRONESIMEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "LIBRAZHID- Q. STUDE (SHITESAT) " LOTI 2
(TOKE ARE, KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFRUTORE)

Nr.	PRONARI	Z.K.	NR. PAS	Lloji i pasurisë	Sip. e shprons. me VKM nr.715 dt.29.10.2014	Sip. e shprons.	Çmimi (lek/m2)	Vlera (Lek)	Kultura Bujqësore. Drufr. Vlera (lek)	Vlera totale (lek)	Shënime
	Emri - Atësia - Mbiemri										
	Fshati Dorëz Komuna Qendër Z.K. 1517										
1	Shefki Dosku	1517	678		390				86000	86000	Konfirmim ZVRPP
2	Xhemal Dosku	1517	675		145				130000	130000	Konfirmim ZVRPP
3	Shaban Dosku	1517	666/12		93				7400	7400	Konfirmim ZVRPP
4	Sami Dosku	1517	666/11		68				12500	12500	Konfirmim ZVRPP
5	Drini Abaz Dosku	1517	666/10		47				10000	10000	Konfirmim ZVRPP
6	Gafur Dosku	1517	666/9		92				2400	2400	Konfirmim ZVRPP
7	Riza Dosku	1517	663/9		53				14000	14000	Konfirmim ZVRPP
8	Riza Dosku	1517	663/11		41				11500	11500	Konfirmim ZVRPP
9	Idajet Biçaku	1517	663/8		31				7500	7500	Konfirmim ZVRPP



10	Bujar Muça	1517	650/4		338				32400	32400	Konfirmim ZVRPP
11	Naze Muça	1517	650/3		211				15900	15900	Konfirmim ZVRPP
12	Petrit Allushi	1517	1/2		526				330000	330000	Konfirmim ZVRPP
13	Petrit Allushi	1517	1/3		76				36000	36000	Konfirmim ZVRPP
14	Naze Musa Muça	1517	654/1	Arë		261	154	40194		40194	Konfirmim ZVRPP
Fshati Zgoshë Komuna Lunik Z.K. 3913											
15	Ismail Qoshi	3913	540		218				54250	54250	Konfirmim ZVRPP
16	Nazmi Qoshi	3913	538		230				20600	20600	Konfirmim ZVRPP
17	Dhimiter (Bashkim) Qoshi	3913	536		184				35550	35550	Konfirmim ZVRPP
18	Nazmi Qoshi	3913	535/1		483				40700	40700	Konfirmim ZVRPP
19	Gjelberim Alla	3913	520/1		149				19500	19500	Konfirmim ZVRPP
20	Hamit Shuli	3913	520/2		193				19500	19500	Konfirmim ZVRPP
21	Xhezar Alla	3913	56		454				25650	25650	Konfirmim ZVRPP
22	Uran Alla	3913	57		448				21300	21300	Konfirmim ZVRPP
23	Arben Alla	3913	71		520				19500	19500	Konfirmim ZVRPP
24	Hamide Alla	3913	72		132				44200	44200	Konfirmim ZVRPP
25	Haki Alla	3913	81		327				41200	41200	Konfirmim ZVRPP
26	Beqir Dilaver Shpata	3913	558	Arë		316	191	60356	132600	192956	Konfirmim ZVRPP
27	Shefki Hasan Qoli	3913	576/1	Arë		346	191	66086	124800	190886	Konfirmim ZVRPP
28	Hazbi Dilaver Boci	3913	560/1	Arë		296	191	56536	179000	235536	Konfirmim ZVRPP
29	Qamil Izet Boci	3913	295/3	Arë		80	191	15280	79500	94780	Konfirmim ZVRPP
30	Qamil Izet Boci	3913	499	Arë		250	191	47750	132000	179750	Konfirmim ZVRPP
31	Gjelberim Xhaferr Alla	3913	559/1	Arë		155	191	29605		29605	Konfirmim ZVRPP
32	Izmir Xhaferr Alla	3913	559/2	Arë		140	191	26740		26740	Konfirmim ZVRPP
33	Andon Xhaferr Alla	3913	559/3	Arë		140	191	26740		26740	Konfirmim ZVRPP
34	Jani Beqir Qoshi	3913	753	Arë		295	191	56345		56345	Konfirmim ZVRPP
					5449			425632	1685450	2111082	

**VENDIM**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2015-1247/635, datë 29.6.2015, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Panajot Miçi Kolo, i datëlindjes 2.2.1926, vdekur në datën 31.12.1958 në fshatin Karroq- komuna Livadhja.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1468, datë 16.7.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Romeo Beluli, i biri i Myfitit dhe Elmës, i datëlindjes 18.3.1968, dhe caktimin e shtetases Mimoza Beluli si kujdestare të pasurisë së tij.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë